



Përshkrimi i Programit

1. Programi i studimit Master i Shkencave në Energjitë e Rinovueshme

Programi i studimit Master i Shkencave në “Energjitë e Rinovueshme” ofrohet në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës dhe synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të analizuar, projektuar dhe menaxhuar sisteme të qëndrueshme energjetike. Programi fokusohet në përdorimin dhe integrimin e teknologjive të energjisë së pastër, me rëndësi të veçantë për sektorët e bujqësisë, mjedisit, industrisë agro-ushqimore dhe zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Ky program është ndërtuar mbi një qasje ndërdisiplinore, duke ndërthurur njohuri nga inxhinieria, energjetika, bujqësia, shkencat natyrore, mjedisi dhe ekonomia. Përmbajtja e tij reflekton nevojat aktuale të tranzicionit energjetik, objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe orientimet e politikave evropiane në fushën e klimës, energjisë dhe eficiencës së burimeve.

Nëpërmjet këtij formimi, studentët zhvillojnë kompetenca për vlerësimin e potencialeve të burimeve të rinovueshme, zbatimin e teknologjive energjetike të pastra, menaxhimin e projekteve energjetike dhe hartimin e zgjidhjeve praktike për përdorimin racional të energjisë në kontekste bujqësore, mjedisore dhe industriale.

2. Pse një Master në “Energji të Rinovueshme”?

- Për të përgatitur specialistë me njohuri të avancuara në prodhimin, integrimin dhe menaxhimin e energjisë nga burime të rinovueshme.
- Për të formuar profesionistë të aftë të analizojnë dhe vlerësojnë aspektet teknike, ekonomike dhe mjedisore të burimeve të ndryshme të energjisë.
- Për të përgatitur specialistë që mund të vlerësojnë efikasitetin ekonomik dhe mjedisor të teknologjive të energjisë së rinovueshme.
- Për t’iu përgjigjur nevojave të tregut të punës për ekspertë në fushën e tranzicionit energjetik, eficiencës së energjisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- Për të zhvilluar te studentët kompetenca më të thelluara kërkimore, të nevojshme për studime të mëtejshme, projekte shkencore dhe zgjidhje aplikative në sektorin e energjisë.
- Për të mbështetur përdorimin më të gjerë të teknologjive të pastra në sektorë si bujqësia, mjedisi, industria agro-ushqimore dhe zhvillimi rural.

3. Kompetencat e të diplomuarve

Të diplomuarit në programin Master i Shkencave në “Energji të Rinovueshme” fitojnë kompetenca për të:

- Vlerësuar potencialet e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme, si bioenergja, energjia diellore, energjia e erës, energjia gjeotermale dhe energjia hidrike, si dhe për të propozuar mënyrat më efikase të përdorimit të tyre.
- Projektuar, analizuar dhe optimizuar sisteme të energjisë së rinovueshme, përfshirë sistemet fotovoltaike, kolektorët termikë diellorë, sistemet e energjisë së erës, teknologjitë e trajtimit të biomasës për prodhim bioenergje, si dhe sisteme hibride të lidhura me rrjetin ose jashtë tij.
- Zbatuar strategji për integrimin e burimeve të rinovueshme në sistemin energjetik, duke marrë në konsideratë teknologjitë e ruajtjes së energjisë, shpërndarjen, stabilitetin e rrjetit dhe menaxhimin e kërkesës për energji.
- Kryer kërkime shkencore dhe aplikative për të adresuar sfidat aktuale dhe të reja në fushën e prodhimit, integritit dhe përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme.
- Analizuar dhe vlerësuar aspektet ekonomike, mjedisore dhe rregullatore të sistemeve energjetike, duke përfshirë politikat energjetike, koston e teknologjive, ndikimet mjedisore dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.
- Përdorur mjete analitike dhe modele vlerësimi, si analiza e ciklit të jetës LCA, modelet e planifikimit energjetik si LEAP, si dhe instrumente të tjera për analizën tekniko-ekonomike dhe mjedisore të projekteve energjetike.

4. Punëdhënësit e mundshëm dhe/ose rruga e karrierës

Potencialisht, të diplomuarit në programin Master i Shkencave në “Energji të Rinovueshme” mund të punësohen në:

- Kompani të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë, përfshirë operatorë publikë dhe privatë që zhvillojnë ose menaxhojnë sisteme energjetike.
- Kompani që operojnë në sektorin e energjive të rinovueshme, si energjia diellore, energjia e erës, bioenergja, energjia hidrike dhe sistemet hibride.
- Kompani projektimi, instalimi dhe mirëmbajtjeje të sistemeve të energjisë së rinovueshme, përfshirë sistemet fotovoltaike, kolektorët termikë diellorë, sistemet e biomasës dhe zgjidhjet e ruajtjes së energjisë.
- Aktivitete mbështetëse në sektorin e energjisë, si tregtia e pajisjeve energjetike, shërbimet teknike, mirëmbajtja e impianteve, auditimi energjetik dhe konsulenca tekniko-ekonomike.
- Institucione publike dhe agjenci rregullatore, që lidhen me politikat energjetike, eficiencën e energjisë, klimën, mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

- Institucione kërkimore, universitete dhe qendra studimore, ku mund të angazhohen në kërkim shkencor, projekte zhvillimore dhe analiza të sistemeve energjetike.
- Organizata joqeveritare dhe organizata ndërkombëtare, që punojnë në fushën e energjisë së pastër, zhvillimit rural, mbrojtjes së mjedisit, klimës dhe qëndrueshmërisë.
- Sektori agro-ushqimor dhe rural, ku mund të kontribuojnë në përdorimin e energjive të rinovueshme, eficiencën e energjisë, valorizimin energjetik të biomasës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve.

5. Alumni të cilët mund të shërbejnë si shembull

- Anduel Çekrezi - Founder & CEO of AI EnergyX, working in energy trading, renewable energy and innovative energy systems in the Western Balkans
- Sidorela Kaci - Eksperte ne Kompaninë SHIMAJ SOLAR POWER
- Evadiola Gjata - Inxhinier e Energjisë së Rinovueshme dhe E-Mobilitetit me mbi 10 vite përvojë në energjinë diellore, infrastrukturën për automjetet elektrike dhe zgjidhjet klimatike, vetepunesuar
- Albert Vrapit - Drejtues Sektorit në OSSHE
- Donald Muçaj - Instituti i Gjeo Shkencës

6. Si zbatohet ndërdisiplinarteti i programit?

- ECTS në Shkencat e Natyrës 30%
- ECTS në Shkencat Teknike 45%
- ECTS në Shkencat Sociale 25%

7. Cilat programe Bachelor sugjerohen për këtë Master

- Diplomë Bachelor në UBT: Shkenca Bujqësore dhe Siguri Ushqimi, Inxhinieri Mjedisit dhe Uji, Teknologji Informacioni në Bujqësi dhe Mjedis, Planifikim dhe Arkitekturë Peizazhi, Menaxhim Biznesi, Ekonomiks, Inxhinieri Pyjore.
- Diplomë Bachelor në Shkencat e Natyrës
- Diplomë Bachelor në Shkencat Inxhinierike
- Me module plotësuese, programi mund të ndiqet edhe nga studentë të diplomuar në programe të tjera Bachelor.